



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:232444

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647937

KPPP.nr. 1732/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqëria Tregtare “Intereuropa Kosova” L.L.C., me numër unik identifikues 810518441 dhe me seli në Prishtinë, Zona Industriale, p.n., të cilin e përfaqëson Ilaz Ramajli, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shoqëria Tregtare Martano L.L.C., me numër unik identifikues 811936428 dhe me seli në Graçanicë, Livagjë, rr. “Miladina Stevica”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.Q., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 633/2023 të datës 02.10.2023, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Shoqëria Tregtare Martano L.L.C., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 633/2023 të datës 02.10.2023, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të Shoqëria Tregtare “Intereuropa Kosova” L.L.C., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 633/2023 të datës 02.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve - Faturës nr. 1022007465, e datës 16.08.2022 dhe Faturës nr. 1022008456, e datës 15.09.2022, duke detyruar debitorin Shoqëria Tregtare Martano L.L.C., që në emër të borxhit nga faturat e lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 3,800.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 02.10.2023, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në shumë prej 156.00 EUR.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor duke theksuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk kanë tiparet e dokumentit të besueshëm pasi që në të njëjtat nuk është specifikuar afati i përmbushjes së detyrimit, si dhe nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit për prapësim në shumë prej 215.00 EUR.

Kreditore, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke shtuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor i plotësojnë të gjitha kushtet sipas nenit 29, par 3 të LPP-së, si dhe për secilën faturë të përfshirë në propozimin për përmbarim, ka depozituar CMR-në në fund të cilit është nënshkrimi dhe vula e debitorit për pranimin e mallit dhe dokumentacionit përcjellës. Ka shtuar se mënyra e dorëzimit të një fature dhe nënshkrimi i faturës nuk janë kushte në mënyrë që një dokument i besueshëm të konsiderohet i përshtatshëm për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet: Faturë nr. 1022007465, e datës 16.08.2022 dhe Faturë nr. 1022008456, e datës 15.09.2022, në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se faturat e lartcekura nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se të njëjtat nuk janë pranuar me rregull nga debitori.

Gjykata vlerësoi edhe CMR-të si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga debitori mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga fatura. Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e kreditorit se debitori ka pranuar faturat kontestuese përmes adresës elektronike, por që nga këto komunikime të bashkangjitura nga kreditori në propozimin për përmbarim, në asnjërën prej tyre nuk evidentohet se debitori ka pranuar shprehimisht faturat objekt i këtij përmbarimi dhe atë pa kundërshtim.

Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përmbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1732/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.